

Kamëz, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Blerje Karburanti”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**09100000-0 Karburante**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**2,074,900** (dymilion e shtatëdhjetë e katërmijë e nëntëqind) lekë pa TVSH

*Autoriteti kontraktor ka llogaritur fondin limit duke marre 3(tre) oferta nga operatorët ekonomike që operojnë në treg dhe duke perlllogaritur vlerën mesatare të tyre në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi i parë pika b), të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formulari i ofertës, sipas shtojcës 1;

*(referuar vkm 285 dt.19.05.2021, ndryshuar me vkm nr.710 dt.24.11.2021)*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerë së parashikuar të kontratës.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare perkatësisht 2020, 2021 dhe 2022, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. **Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare..”

**Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:**  
c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

**4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritjet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore sa 40% e vlerës së kontratës bazuar në nenin 43 pika 2 e VKM-së, dhe pasqyrat financiare për vitin e fundit (2020) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023, sipas ligjit 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Janë kërkuar këto kriteret në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/c** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. **Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**”

Në **nenin 40 “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të**

*deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*




Ndërsa në **nenin 55** “Procedurë e hapur e thjeshtuar” **pika 4/b** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kritere të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

**2.3.2** Operatori Ofertues duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Kamëz, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj), për të cilën duhet të paraqesë:

-  Dokumentacionin e pronësisë të stacionit të karburantit ose kontratë qiraje/marrëveshje etj.
-  Vertetimin teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike në fushën e tregëtimit të naftës dhe nenprodukteve të tij.
-  Licence për stacionin e shitjes së karburanteve (për tregti me pakicë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 5/a, ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Realizimi i kësaj kontrate ka për qëllim furnizimin me karburant të Bashkisë Kamëz ku përfshihen mjetet e Policisë Bashkiake, IMT, Njësive Administrative, Sektorit I MZSH, Ndermarrja Pastrim Gjelerim e Treg, mjetet në shërbim të administratës, etj, ndaj është menduar që operatori ekonomik të ketë të paktën 1 stacion shpërndarje të karburantit brenda territorit të Bashkisë KAMËZ (pikë

të furnizimit me karburant), për të cilën duhet të disponojë edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**2.3.3** Operatori ofertues do të paraqesë dokumentacion se disponon paisjet për ofrimin e shërbimit sipas VKM-së nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", furnizimi me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në VKM Nr.561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të karburantit të parashikuar për çdo mjet që do të furnizohet.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknim dhe Industrial që verteton se ka tregtuar karburante sipas standarteve të Legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka marrë penalitetet për shkelje të cilësisë gjatë vitit 2023.

**Argumentimi:** Në lidhje me këto pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vertetim që leshohet nga ISHTI, ku të referon kërkesat e mësipërme në funksion dhe zbatim të ligjit Nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë", si dhe Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar. Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton që Operatori Ekonomik ofron cilësi duke respektuar standardet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standarteve bashkëkohore. Vertetimi i lëshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme ose certifikatë "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë" EN-ISO 9001:2015 ose ekuivalent, dhe të lëshuar nga organe të akredituara.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>" në të cilët përcaktohet se, citojmë: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së produkteve në mënyrë të qëndrueshme (ISO 9001), ku në rastin konkret është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së mallrave që ofron.

Njësia e prokurimit përcaktoj kërkesën si më lart, duke qënë se është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, por edhe sepse mbi të gjitha i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre (besueshmërinë) për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.3.6** Operatori ofertues duhet të paraqesë Raport Analizë të cilësisë së karburantit të lëshuar brenda 3 muajve nga dita e hapjes së ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin 40, pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. objekt i kontratës. Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

## II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet.

*Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Komisioni i Prokurimeve me Vlere te Vogel ia bashkangjit procedurës së prokurimit me vlere te vogel sa me sipercituar dhe mbi bazën e tyre procedon edhe me hartimin e kriterëve për kualifikim.*

### SPECIFIKIME TEKNIKE

#### GAZOIL 10 PPM ULSD

Gazoil 10 ppm ULSD duhet të jetë në përputhje me standardin SSHEN 590: 2013+A1:2017 sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Nr	Emertimi	Njesia	Kufijte e lejuar	
			Minimumi	Maximumi
1	Numri cetanit		51	-
2	Indeks i cetanit		46.0	-
3	Densiteti ne 15 C	kg/m <sup>3</sup>	820	845
4	Hidrokarbure aromatic policiklike*	%(m/m)	-	8.0
5	Permbajtja e squfurit	mg/kg	-	10.0
6	Pika e flakerimit	oC	55	-
7	Mbetja e karbonit (ne 10 % mbetje distilimi)*	%(m/m)	-	0.30
8	Permbajtja e hirit	%(m/m)	-	0.01
9	Permbajtja e esterit metilik te acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7,0
10	Viskoziteti ne 40 oC	mm <sup>2</sup> /s	2.00	4.50
11	Permbajtja e ujit	mg/kg	-	200
12	Lubriciteti, diametri i korrektuar i gervishtjes (ësd 1,4) ne 60 <sup>o</sup> C	µm	-	460
13	Pika e turbullimit	oC	-	-
14	Ndotja e pergjithshme	mg/kg	-	24



15	Stabiliteti i oksidimit	g/m <sup>3</sup>	-	25
----	-------------------------	------------------	---	----

### **BENZINË (PREMIUM UNL 10PPM)**

Të dhënat teknike të benzine (Premium Unl 10 PPM) i referohen standartin S SH (EN 228: 2012) A1:2017 sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri

Emertimi	Njesia	Kufijte e lejuar	
		Minimumi	Maximumi
Numri Oktanit kerkimor RON		95	
Numri Oktanit motorrik MON		85	
Densiteti ne 15 ° C	kg/m <sup>3</sup>	720	775
Permbajtja e squfurit	mg/kg		10
Korrozioni I shufres se bakrit (3 ore/50°C	Renditje	klasa I	10.0
Tensioni I avujve	kPa		-
Pamja e jashtme		E paster dhe e tejdukshme	0.30
Distilimi		22	50
Distilimi deri 70°C	%(v/v)	46	72
Distilimi deri 100°C	%(v/v)	75	
Distilimi deri 150°C	°C		210
Pika finale e distilimit	%(v/v)		2
Permbajtja e tipit te hidrokarburit			
Olefinat	%(v/v)		18
Aromatiket	%(v/v)		35
Permbajtja e benzenit	%(v/v)		1
Permbajtja e oksigjenit	%(m/m)		3.7
Permbajtja e komponimeve oksigjenore			
Methanol (alkol metilik)	%(v/v)		3
Etanol (alkool metilik)			10

Alkool terc butil			15
Etere ( me 5 ose me shume atome C)			22

Të dhënat teknike të naftës dhe benzinës i referohen standartit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit dhe që ka statusin e standartit shqiptar (S SH);

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë bazuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë me **20.10.2023, ora 10.<sup>00</sup>**, **vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur te grupi punes i ngritur per hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve te vecanta teknike, te procedures ne reference.

### **NJËSIA E PROKURIMIT**